



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____. 2021

V E N D I M

Nr. _____, datë _____._____. 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 233 regj, datë 14.12.2021, të paraqitur nga subjekti ankues, L. D., kundër Zyrës Vendore Arsimore Shkodër¹, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, L. D., në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon ndër të tjera se, i drejtohet institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për herë të dytë, pasi nga ana e ZVA Shkodër i mohohet e drejta e emërimit si mësuese në shkollën “Jordan Misja” në Shkodër. Sipas saj, edhe pse ajo është fituese në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2017-2018, renditur e dyta në Prefekturën e Shkodrës, në profilin Biologji, i ofrohen pozicione pune në shkollat e zonës së Dukagjinit dhe jo të qytetit të Shkodrës.

Ankuesja pretendon se nga ndërhyrjet e paligjshme pranë ZVA Shkodër, asaj i mohohet e drejta e informimit, duke mos i vënë në dispozicion kopje të dokumentave të mëposhtme:

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën ZVA Shkodër

² Diskriminim në formën e viktimizimit, pasi KMD është shprehur me vendim diskriminimi ndaj ZVA Shkodër për një ankesë të mëparshme të ankuses.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

- Raporti i Monitorimit të MASR, dalë në tetor-nëntor 2017;
- Raporti i Monitorimit të MASR, dalë në maj 2018;
- Rekomandimet e MASR, autorizuar ish-DAR, pas ankesave në maj 2018;

Sa më sipër, ankuesja sqaron se i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 4 herë (1 herë në vitin 2019 dhe 3 herë në vitin 2021), por nuk ka i janë vënë në dispozicion dokumentat e sipërcituar.

Sipas ankueses, edhe në rastet kur ZVA-së Shkodër i propozohet emërimi i ankueses, është refuzuar nga ish-drejtuesja, sapo është njohur me vendimin e KMD.

Në muajin Gusht të vitit 2021, ankuesja pretendon se ka vënë në dijeni ZVA-në Shkodër lidhur me kontratën e paligjshme të mësueses së shkollës “Jordan Misja”, znj. A. S., dhe pas marrjes së këtij informacioni ky institucion ka bërë ndërprerjen e kontratës. Pasi është vënë në dijeni të këtij fakti, ankuesja pretendon se ka paraqitur kërkesë pranë ZVA-së Shkodër për punësimin në vendin e saj dhe është informuar se znj. A. S. është rikthyer sërish në pozicionin e mëparshëm të punës.

Përsa më sipër, ankuesja pretendon diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe për çdo shkak tjetër, pasi edhe pas vendimit të Komisionerit ajo nuk është emëruar në pozicionin që i takon. Gjithashtu, për shkak se ajo ka paraqitur ankesë pranë KMD-së, pretendon se është diskriminuar në formën e viktimizimit nga ana e këtij institucioni, pasi i ofrohen vetëm pozicione në zonën e Dukagjinit dhe jo në shkollën “Jordan Misja” Shkodër.

Në përfundim, ankuesja kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të merren masat e mëposhtme:

1. Ndërprerjen e kontratës së znj. A. S., pasi sipas saj procedura e emërimit është në shkelje të legjislacionit;
2. Të tërheqë nga ZVA Shkodër dokumentet e mësipërme që nuk i janë vënë në dispozicion më parë;
3. Të konstatojë diskriminimin në formën e viktimizimit duke e emëruar në gjimnazin “Jordan Misja”, pasi është vendosur përballë shanseve jo të barabarta nga ZVA Shkodër.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar⁴, në nenin 3/1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës së parë Nr. 79 rregj., datë 08.07.2019, të ankueses rezulton që, L. D., nga viti 2002 ka filluar punë si mësuese provizore në Sistemin Arsimor në shkolla të ndryshme të qytetit të Shkodrës. Në muajin dhjetor 2016, ankuesja ka filluar punë me kontratë të përkohshme në pozicionin e mësueses në profilin Biologji-Kimi, në shkollën e mesme “Jordan Misja”, Shkodër.

Sipas informacionit të administruar, ankuesja ka konkuruar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, ndër vite, duke u vlerësuar si më poshtë:

- në vitin 2015-2016, ka qenë e renditur në vend të pestë në profilin, Kimi, me 55.8 pikë
- në vitin 2016-2017, ka qenë e renditur në vend të dytë në profilin Biologji, me 57.3 pikë.

Ankueses i ishin ofruar vende të lira me ngarkesë mësimore të plotë me kontratë prove një vjeçare për vitin shkollor 2018-2019, në tre institucione arsimore shkollore, konkretisht shkolla Ndreaj, shkolla Gimaj dhe në institucionin arsimor shkolla Elbace, por i kishte refuzuar.

Në muajin Maj 2017, mësuesja që ankuesja zëvendësoi, për arsye personale ka ndërprerë marrëdhënien e punës, duke dhënë kështu dorëheqjen nga pozicioni i punës. Në këtë moment, drejtorja e shkollës “Jordan Misja”, i është drejtuar ish-Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër (sot ZVA Shkodër) duke e njoftuar se: *“...pas përfundimit të procedurave për ndërprerjen e kontratës së punës me mësuesen J. Sh., vendi është i lirë. Në këtë vend, është punësuar me kontratë të përkohshme L. D.. Për arsye të ndryshimit të Kurrikulës dhe pritshmërisë së numrit të nxënësve të klasës, kjo ngarkesë mësimore për vitin shkollor 2017-2018, pritët të reduktohet, gjë për të cilën kërkojmë të vlerësohet shpallja ose jo e këtij vendi pune në këto kushte. Meqënëse është fundi i vitit shkollor, propozojmë që mësuesja aktuale të vazhdojë deri në përfundimin e këtij viti shkollor.”*

Në përgjigje të saj, ZVA Shkodër, i është drejtuar Komisionit të Vlerësimit (të ish-DAR Shkodër), duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...njoftojmë komisionin e vlerësimit se pas propozimit*

⁴ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

të drejtorisë së shkollës ‘Jordan Misja’ vendi i lirë profili Biokimi, do të shpallet në fillim të vitit shkollor në varësi të ngarkesës mësimore për atë vend pune.”

Me anë të shkresës⁵ datë 05.06.2017, ankuesja i është drejtuar DAR Shkodër dhe Drejtorisë së shkollës “Jordan Misja”, duke i parashtruar se: *“Meqë prej 7 muajsh punoj pranë kësaj shkolle si mësuese provizore dhe prej tre muajsh vendi im është shpallur vend i lirë pune dhe duke qenë fituese e vendit të parë në DAR Shkodër, në degën Biologji, në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’, paraqes kërkesën për lidhjen e kontratës 1-vjeçare të provës sipas legjislacionit në fuqi”.*

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, ish-DAR Shkodër me anë të shkresës nr. 1449/1 prot., datë 07.06.2017, i është drejtuar ankueses, duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...Në bazë të informacionit të marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Portalit ‘Mësues për Shqipërinë’, i vitit 2016, ju rezultoni me 57.3 pikë dhe jeni e 2-ta në renditje në profilin Biologji. Me kreditet e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’ të vitit 2017, deri më tani nuk kemi asnjë të punësuar me kontratë prove (vetëm me kontratë të përkohshme), siç jeni edhe ju, në profilin biologji dhe kimi. Çdo vend i lirë i shpallur do të plotësohet vetëm në zbatim të Udhëzimit nr. 38”.*

Në vijim, ankuesja në muajin Tetor 2017, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR), në të cilën ka vënë në dijeni lidhur me problematikën e mospunësimit të saj si mësuese e profilit Biologji-Kimi nga ana e ish-DAR Shkodër. Në përgjigje të kërkesës së ankueses, MASR, pas verifikimeve të kryera i ka kthyer përgjigje⁶, duke e sqaruar ndër të tjera se: *“...Një grup pune i ngritur nga MASR, pas verifikimit të rastit si dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të administruar nga DAR Shkodër dhe shkolla e mesme ‘Jordan Misja’, konkludoi se në muajin dhjetor 2016, ju jeni punësuar me kontratë të përkohshme si zëvendësuese në gjimnazin ‘Jordan Misja’, duke respektuar renditjen në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’. Në mars 2017, mësuesja të cilën ju zëvendësuat, për arsye shëndetësore, ndërpret marrëdhëniet e punës në shkollën ‘Jordan Misja’. Drejtoresha e shkollës nuk ka shpallur vendin e lirë të punës për mësues Biologji-Kimi, për shkak se parashikohej rënie e numrit të orëve të këtij profili. Për klasën e XI në të cilën zbatohet kurrikula mbi bazë kompetencash, nuk zhvillohet më lënda ‘Aftësimi për jetën’, duke zbritur 8 orë më pak ngarkesë mësimore të profilit Biologji-Kimi. Gjithashtu, në planifikimin paraprak të bërë në muajin Maj për vitin shkollor 2017-2018, parashikohej rënie e numrit të nxënësve që rregjistrohen në klasën e X-të, për pasojë edhe rënie e numrit të klasave të X-ta. Aktualisht, për vitin shkollor 2017-2018, janë 7 klasa të X-ta nga 8 që ishin një vit më parë. Pra, nga totali i orëve të këtij profili ka një rënie prej rreth 14 orë gjithsej. Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore në vitin shkollor 2017-2018, drejtorja e shkollës ka plotësuar me normë mësuesit ekzistues të shkollës dhe kanë ngelur vetëm 10 orë, të cilat mbulohen nga mësuesja e shkollës ‘28 Nëntori’, e cila është mësuese në sistem.”*

Lidhur me ankesën e L. D., mbi emërimin e një mësuesi tjetër të profilit Biologji-Kimi në shkollën “Jordan Misja”, MASR në shkresën e sipërcituar ka sqaruar se: *“...Sa i përket vendit tjetër të lirë në këtë shkollë, të mësueses së profilit Biologji-Kimi të dalë në pension, Komisioni i*

⁵ Protokolluar pranë DAR Shkodër me nr. 1449 prot., datë 06.06.2017.

⁶ Me anë të shkresës Nr. 8450/1 prot., datë 18.10.2017.

Vlerësimi i ngritur pranë DAR Shkodër, në muajin shtator 2017, ka kryer lëvizjen paralele të detyruar të mësueses A. S. nga shkolla 9-vjeçare 'Gjergj Vate Martini', Velipojë, me ngarkesë mësimore të plotë dhe të përhershme”.

Gjithashtu nga ana e MASR, me anë të shkresës Nr. 8450/4 prot., datë 24.10.2017 i është vënë në dispozicion ankueses një kopje e Raportit të grupit të punës së MASR “Mbi Verifikimin e Ankimimit Nr. 8450, datë 12.09.2017 të znj. L. D., në lidhje me procedurat e punësimit të saj në shkollën e mesme ‘Jordan Misja’, Drejtoria Arsimore Rajonale, Shkodër”.

Nga ana e MASR, referuar kërkesës së L. D. është ngritur sërish një grup pune për verifikimin e ankesave të saj, i cili në përfundim të procedurës ka dalë me raportin me nr. 8943/3 prot., datë 13.10.2017. Në këtë raport, i cili i është vënë në dispozicion edhe ankueses, është konstatuar ndër të tjera se: “...Sipas listës së DAR Shkodër nr. 1932/2 prot., datë 11.09.2017 ‘Mësues për Shqipërinë’ 2016-2017 për statusin e punësimit shtator 2017, rezulton se janë emëruar gjithsej 22 mësues duke respektuar renditjen e kandidatëve, sipas pikëve totale, për çdo profil/lëndë... Lidhur me pretendimin e denoncuesit mbi emërimin e mësuesit në shkollën e fshatit Melgush, në janar 2017, drejtori i DAR informoi se bëhet fjalë për mësuesin A. V. Sipas dokumentacionit të administruar nga DAR Shkodër rezulton se kandidati A. V. ka konkuruar nëpërmjet portalit ‘Mësues për Shqipërinë’ 2015, profili Biologji dhe në listën përfundimtare është renditur i dyti, me 57.4 pikë. Më datë 16.01.2017, i njoftuar nga Komisioni i Vlerësimit të DAR Shkodër, mësuesi A. V. zgjedh të punojë në vendin e lirë në shkollën ‘Sh. Banushi’ Melgushë, në profilin Biologji-Kimi, me ngarkesë mësimore të plotë. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se kandidati A. V. gjendet i renditur në listën e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’ 2016, edhe pse është i punësuar, sqarojmë se mësuesi ka aplikuar në portalin e vitit 2016, e cila përkon me kohën para punësimit të tij në janar 2017...Pra ky emërim është bërë përpara datës 18.03.2017, në të cilën është shpallur renditja përfundimtare e kandidatëve që kanë konkuruar nëpërmjet portalit ‘Mësues për Shqipërinë’ 2016. Përsa më sipër pretendimet e ngritura në denoncim nuk qëndrojnë”.

Nga referim të provave të vëna në dispozicion nga ana e palëve në proces gjatë shqyrtimit të ankesës së saj me Nr. 79 rregj., datë 08.07.2019, u analizuan tre momente nga ana e Komisionerit, lidhur me trajtimin e pabarabartë nga ana e ish-DAR Shkodër. Momenti i parë kishte të bënte me mosemërimin e ankueses në pozicionin mësueses së profilit Biologji-Kimi në shkollën e mesme “Jordan Misja”. Momenti i dytë me mosrespektimin e renditjes së emërimit të kandidatëve të portalit “Mësues për Shqipërinë” 2016-2017, të profilit Biologji-Kimi. Ndërsa momenti i tretë, lidhej me emërimin e një mësuesi tjetër në profilin Biologji-Kimi, në shkollën e mesme “Jordan Misja” dhe jo të ankueses.

Në përfundim të analizës së bërë nga ana e Komisionerit gjatë shqyrtimit të ankesës së mëparshme me Nr. 79 rregj., datë 08.07.2019, u dol në konkluzionin se:

- nuk konstatohet se nga ana e ish-DAR Shkodër apo drejtorisë së shkollës “Jordan Misja”, të jenë përdorur praktika të cilat vënë përpara trajtimin të pabarabartë ankuesen në raport me punonjës të tjerë.
- në vlerësim të dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga ish-DAR Shkodër dhe shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, për emërimet e punonjësve arsimorë, Komisioneri konstatoi se emërimi i shtetasit A. V. ishte bërë në kundërshtim me legjislacionin e arsimit, duke vënë kështu ankuesen në kushte të pafavorshme.
- ankuesja nuk ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe pafavorshëm, krahasuar me shtetasen A. S., mësuesen e shkollës së mesme “Jordan Misja” Shkodër.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përfundim të shqyrtimit të ankesës Nr. 79 rregj., datë 08.07.2019, me vendimin **Nr. 137, datë 02.10.2019** konstatoi:

1. Diskriminimin e shtetasës L. D., nga ana e ish- Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër (aktualisht Zyra Vendore Arsimore Shkodër), për shkak të bindjes politike, lidhur me procedurën e emërimit të mësuesit të lëndës Biologji-Kimisë në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë.
2. Në referim të pikës 1, urdhëroi Zyrën Vendore Arsimore Shkodër, si subjekt që kishte konsumuar sjelljen diskriminuese, në zbatim të pikës 8, të Kreut 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “*Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar*”, të marrte masat e menjëhershme për shpalljen e pavlefshme të kontratës së lidhur në shkelje të kësaj dispozite me shtetasin A. V.
3. Në referim të pikës 1, urdhëroi Zyrën Vendore Arsimore Shkodër, si subjekt që kishte konsumuar sjelljen diskriminuese, të bënte emërimin e L. D. me ngarkesë të plotë mësimore dhe të përhershme.

Pas vendimarrjes së sipërcituar, ZVA Shkodër, paraqiti pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkesë padinë me objekt: “*Shfuqizimin e vendimit Nr. 137, datë 02.10.2019*”. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, la në fuqi vendimarrjen e Komisionerit sa i përket shqyrtimit të ankesës së L. D. Aktualisht, rezulton që vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është ankimuar nga ana e ZVA Shkodër dhe është ende në proces shqyrtimi nga ana e Gjykatës së Apelit Administrativ.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” dhe “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose **është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një anekse tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;** ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para

hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Duke mbajtur në konsideratë standartet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se:

- **Në lidhje me pretendimin për trajtim të pafavorshëm përsa i përket pozicioneve të punës që i janë ofruar ankueses në shkollat e zonës së Dukagjinit dhe jo të qytetit të Shkodrës, si dhe mosemërimin e saj në shkollën e mesme “Jordan Misja”.**

Nga aktet e administruara, rezulton se ankueses gjatë vitit shkollor 2018-2019, i janë ofruar nga ana e ZVA Shkodër vende të lira me ngarkesë mësimore të plotë me kontratë prove një vjeçare, në tre institucione arsimore shkollore në zonën e Dukagjinit, konkretisht shkolla Ndreaj, shkolla Gimaj dhe në institucionin arsimor shkolla Elbace, por i kishte refuzuar.

Mbështetur në provat e vëna në dispozicion nga ana e ankueses, rezulton që vendet vakante të sipërcituara, i janë ofruar asaj, me proceverbalin datë 25.09.2018, për të cilat ajo ka marrë dijeni dhe ka firmosur në të njëjtën datë, ku dhe ka refuzuar pozicionet e propozuara të punës. Gjithashtu, pretendimet lidhur me mësuesen A. S. dhe mosemërimin në vend të saj në shkollën e mesme Jordan Misja, ankuesja i ka pretenduar edhe në ankesën Nr. 79 rregj., datë 08.07.2019.

Sa i përket pretendimeve të sipërcituara të ankueses në ankesën e paraqitur, Komisioneri evidenton se i ka patur pjesë të shqyrtimit të ankesës së mëparshme të L. D., me Nr. 79 rregj., datë 08.07.2019, për të cilën është shprehur me vendimin Nr. 137, datë 02.10.2019.

Komisioneri vlerëson se, për të njëjtën çështje të bërë objekt shqyrtimi nga ankuesja nëpërmjet paraqitjes së kësaj ankese, është marrë një vendim i mëparshëm. Pra, nuk jemi në kushtet kur kemi të dhëna të reja, në mënyrë që të mundësohet marrja në shqyrtim e pretendimeve të bëra nga ankuesja në ankesën objekt shqyrtimi. Çështja e parashtruar që përbën objektin e kësaj ankese është e njëjtë me çështjen e marrë më parë në shqyrtim nga ana e Komisionerit dhe për të cilën është marrë një vendim, i cili është kundërshtuar në gjykatë nga ana e ZVA-së Shkodër. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se për ligjen kërkesat e nenit 33/4/c, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe ankesa e paraqitur nuk mund të pranohet pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.

- **Në lidhje me pretendimin e ankueses, sa i përket mosvënies në dispozicion të akteve të kërkuara prej saj nga ana e ZVA Shkodër edhe pas ndërhyrjes së Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

Lidhur me ankesën e bërë nga L. D., për sa i përket mosdhënies së informacionit dhe kthimit të një përgjigjeje zyrtare nga ana e institucioneve kundrejt të cilave ka paraqitur ankesën, Komisioneri vëren se, kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankueses, se institucionet sipërcituar, nuk i janë përgjigjur kërkesave të saj; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sipas këtij ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin *“Për të drejtën e Informimit”*, të ndryshuar; shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike; kryen hetimet e nevojshme administrative gjatë ushtrimit të kompetencave të tij; njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e “sekretit shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi; vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit; nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit; monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit; kryen sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit; bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës; me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit.

Në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, të ndryshuar, përcaktohet procedura e shqyrtimit të ankesave:

“Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore

publike me pjesëmarrjen e palëve. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit".

Përsa më sipër, nëse ankuesja pretendon se edhe pas ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ka marrë informacionin e kërkuar, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente për këtë pjesë të objektit të ankesës së depozituar pranë KMD-së.

Në këtë kontekst, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se institucioni kompetent për shqyrtimin e problematikës së subjektit ankues është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sa më sipër, bazuar në nenin 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, citon shprehimisht se: "...ankesa nuk pranohet nëse...është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji", çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma "b", "c" dhe "ç" të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesja L. D. kundër ZVA Shkodër, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/c/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, L. D., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)

(Fusha: Punësim)